



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I ARKEOLOGJISË DHE TRASHËGIMISË KULTURORE

**PROGRAMI I LËNDËS
DREJTIMI: ARKEOLOGJI DHE TRASHËGIMI KULTURORE**

TITULLI I LËNDËS: HISTORI E SHQIPËRISË 2: MESJETA

Pedagogu: Ph.D.c. Andi REMBECI

Ngarkesa: 6 ETCS(45 leksione dhe 15 seminare)

Lloji i lëndës: disiplinë e formimit të përgjithshëm (bazë)

Programi i studimit: Bachelor

Viti/Semestri: I/II

EKSTRAKT

Në kuadrin e lëndës së Historisë së Mesjetës Shqiptare do të studiohet rrugëtimi historik i popullit shqiptar gjatë Mesjetës. Nga pikëpamja kronologjike lënda shtrihet nga periudha e kalimit prej Antikitetit të Vonë në Mesjetën e Hershme (shek. IV) deri në shfaqjen dhe vërshimin pushtues Osmanë në trojet shqiptare (shek. XIV). Lënda do të trajtojë këto tema kryesore: **1) Hapësira shqiptare në shekujt e parë të Mesjetës (shek. IV-X)**, ku do të shqyrtohet hapësira e trevave shqiptare si pjesë e territoreve bizantine dhe përhapja e krishterimit në to; dyndjet e popujve dhe vendosja e Sllavëve në Ballkan gjatë shek. IV-VIII; formimi i popullit shqiptar dhe vazhdimësia iliro-shqiptare; organizimi administrativ bizantin i hapësirës shqiptare dhe trevat shqiptare gjatë luftërave ndërmjet Mbretërisë Bullgare dhe Perandorisë Bizantine (shek. IX-X). **2) Hapësira Shqiptare gjatë shek. XI-XII.** Në këtë periudhë do të trajtohet zhvillimi i marrëdhënieve feudale në hapësirën shqiptare dhe ndryshimet kryesore që ato sollën; kategorizimi i pronës feudale dhe diferencimi ekonomiko-shoqëror me formimin e klasës së fisnikëve feudale shqiptarë; nga pikëpamja politike do të shtjellohet konflikti i Normanëve me Bizantin dhe pozicioni i shqiptarëve në të; kushtet historike dhe organizimi kishtar në hapësirën shqiptare gjatë shek. VIII-XIV. **3) Luftërat politike në trevat Shqiptare gjatë shek. XII-XIII.** Kjo tematikë do të përqendrohet në studimin dhe analizimin e ngjarjeve politike, si shtrirja e shtetit serb të Rashës në territoret shqiptare dhe pasojat që ajo solli; krijimi i principatave feudale shqiptare, principata e Arbrit; Despotati i Epirit dhe Principata e Arbrit; mbretëria e Sicilisë dhe trevat shqiptare **4) Principatat shqiptare dhe fuqizimi i tyre gjatë shek. XIV.** Kjo temë do të fokusohet në shtjellimin e ngjarjeve

të rëndësishme historike që luajtën rol vendimtar në fuqizimin e principata shqiptare, si gjendja politike në hapësirën shqiptare në fillim të shek. XIV; hapësirat shqiptare në kohën e Stefan Dushanit; principatat shqiptare të shek. XIV. **5) Shoqëria shqiptare në Mesjetë.** Në trajtimin e kësaj teme do të analizohen tiparet e zhvillimit të marrëdhënieve feudale në fshatin shqiptar, rritja e funksionit ekonomik dhe pasqyrimi i tij në aspektin e jashtëm dhe në jetën e brendshme të qytetit dhe shkaqet dhe drejtimit e emigrimeve shqiptare. **6) Kultura dhe arti në periudhën mesjetare.** Gjatë trajtimit të kësaj teme do të ndërmerret një vëzhgim i zhvillimit të kulturës në hapësirën shqiptare gjatë kësaj periudhe, duke u përqendruar tek arsimi dhe letërsia, librat e dorëshkuar mesjetarë (kodikët), arkitektura, skulptura dhe piktura.

TEMAT:

LEKSION 1. Hapësira shqiptare në shekujt e parë të Mesjetës.

- Kalimi nga Antikiteti i Vonë në Mesjetën e Hershme.
- Hapësira shqiptare si provincë e Perandorisë bizantine.
- Përhapja e krishterimit në trevat shqiptare dhe organizimi i tij.

LEKSION 2. Hapësira shqiptare në kohën e dyndjeve të popujve dhe të vendosjes së sllavëve në Ballkan.

- Dyndjet e popujve me karakter kalimtar.
- Dyndjet dhe vendosja e Sllavëve në Ballkan gjatë shek. IV-VIII

LEKSION 3. Formimi i popullit shqiptar.

- Vazhdimësia iliro-shqiptare. Teza dhe antiteza.
- Hapësira gjeografike e shqiptarëve në Mesjetë.

LEKSION 4. Organizimi administrativ dhe jeta politike

- Organizimi administrativ i Themave në hapësirën shqiptare.
- Luftërave ndërmjet Mbretërisë Bullgare dhe Perandorisë Bizantine (shek. IX-X).

LEKSION 5. I. Hapësira shqiptare gjatë shek. XI-XII.

- Zhvillimi i marrëdhënieve feudale në hapësirën shqiptare dhe ndryshimet kryesore që ato sollën.
- Kategorizimi i pronës feudale dhe diferencimi ekonomiko-shoqëror me formimin e klasës së fisnikëve feudalë shqiptarë.

LEKSION 6. II. Hapësira shqiptare gjatë shek. XI-XII.

- Konflikti i Normanëve me Bizantin dhe pozicioni i shqiptarëve në të.
- Kushtet historike dhe organizimi kishtar në hapësirën shqiptare gjatë shek. VIII-XIV.

LEKSION 7. I. Gjendja politike në trevat Shqiptare gjatë shek. XII-XIII.

- Shtirirja e shtetit serb të Rashës në territoret shqiptare dhe pasojat që sollë.
- Krijimi i principatave feudale shqiptare. Principata e Arbrit.

LEKSION 8. II. Gjendja politike në trevat Shqiptare gjatë shek. XII-XIII.

- Despotati i Epirit, Dukati i Durrësit dhe Principata e Arbrit.
- Përplasjet mes Despotatit të Epirit dhe Perandorisë së Nikesë dhe faktori shqiptar.

LEKSION 9. III. Gjendja politike në trevat Shqiptare gjatë shek. XII-XIII.

- Mbretëria e Sicilisë dhe trevat shqiptare.
- Anzhuinët dhe "Regnum Albaniae".

LEKSION 10. Gjendja politike në hapësirën shqiptare në shek. XIV

- Gjendja politike në hapësirën shqiptare në fillim të shek. XIV.
- Hapësira shqiptare në kohën e Stefan Dushanit.

LEKSION 11. Principatat shqiptare të shek. XIV.

LEKSION 12. Republika e Shën Markut (Venediku) në Shqipëri

- Shtirja dhe administrimi i zotërimeve veneciane në hapësirën shqiptare

LEKSION 13. Shoqëria shqiptare në Mesjetë.

- Tiparet e zhvillimit të marrëdhënieve feudale në fshatin shqiptar.
- Rritja e funksionit ekonomik dhe pasqyrimi i tij në aspektin e jashtëm dhe në jetën e brendshme të qytetit

LEKSION 14. Emigrimet e shqiptarëve në Mesjetë. Shkaqet dhe drejtimet.

LEKSION 15. Kultura dhe arti në periudhën mesjetare.

- Zhvillimi të kulturës në hapësirën shqiptare
- Arsimit dhe letërsia
- Librat e dorëshkuar mesjetarë (kodikët)
- Arkitektura, skulptura dhe piktura.

FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT

FREKUENTIMI:

70% pranisë në seminare e domosdoshme.

15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve

KONTROLI I VAZHDUESHËM:

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare)

25 % e notës përfundimtare.

DETYRA E KURSIT:

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 5-10 faqe (format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5)

20 % e notës përfundimtare

KONTROLI PËRFUNDIMTAR:

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri

DETYRIMET E STUDENTËVE PËR LËNDËN

Frekuentim i rregullt në leksione.

Frekuentim i detyruar në të paktën 70% të seminareve të lëndës.

Përgatitja e një ese-je nga 3-5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5.

Pjesëmarrje në testet e pjesshme gjatë semestrit.

Testi (provimi) përfundimtar (i fundit të semestrit)

LITERATURA:

Historia e Popullit Shqiptar, Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Historisë, vëll. I, bot. Toena, Tiranë 2002 (Pjesa e dytë – Mesjeta)

Aleks Buda, *Shënime historike*, vëll. I-II, Tiranë 1986.

Aleksandër Meksi, “Monumentet mesjetare të kultit dhe rrënjët e tyre në antikitetin e vonë”, *Konferenca Kombëtare për formimin e popullit shqiptar, të gjuhës dhe të kulturës së tij*, bot. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 1988.

Aleksandër Meksi, “Të dhëna për historinë e hershme mesjetare të Shqipërisë (fundi i shek. VI – fillimi i shek. IX)”, *Iliria 1* (1989).

Aleksandër Meksi, *Arkitektura mesjetare në Shqipëri, shek. VII-XV*, bot. 8 Nëntori, Tiranë 1983.

Andi Rembeci, Sokol Cunga, *Dorëshkrime Bizantine dhe Pasbizantine në Shqipëri*, Katalog shkencor, bot. FGK-Vatra Tiranë, Tiranë 2010.

Andi Rembeci, «Botime të mbishkrimeve kishtarë bizantine në Shqipëri», *Kërkim 6-7* (shtator-dhjetor 2010 – janar-prill 2011), fq. 134-156 dhe 129-142.

Andi Rembeci, «The codex of the Metropolis of Korça and Selasforus as a Historical Source», *Albanohellenica 4* (2011), fq. 97-112.

Andi Rembeci, Sokol Cunga, «The Byzantine and Post Byzantine collection of manuscripts at the Central State Archive of Tirana and a concordance between the Kodder-Trap Catalogue of Tirana Manuscripts and their actual shelf-number», *Proceedings of the 22nd International Congress of Byzantine Studies*, Sofia, 22-27 August 2011, bot. Sofje 2011, vol. III, fq. 357.

Dhimitër Shuteriqi, “Arianitët, emri dhe gjenealogjia”, *Studime Historike 4* (1965).

Dhimitër Shuteriqi, “Arianitët, zotërimet”, *Studime Historike 1* (1967).

Eqerem Çabej, “Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të vendeve”, *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës – Seria e Shkencave Shoqërore 2* (1958).

Georg Ostrogorsky, *Historia e Perandorisë Bizantine*, bot. Dituria, Tiranë 2007.

Koço Bozhori, “Vëzhgime rreth shtrirjes së emërtimeve Arbanon në kohën bizantine”, *Studime Historike 4* (1972).

Luan Malltezi, *Qytetet e bregdetit shqiptar gjatë sundimit venedikas 1392-1478*, Tiranë 1988.

Oliver Jens Schmitt, *Arbëria venedike (1392-1479)*, Tiranë: K & B, 2007.

Pëllumb Xhufi, "Albania Graeca in the XIV-XV centuries. A survey on the Albanian Colonization in Greece in the Late Middle Age", *Studia Albanica 1-2* (1991).

Pëllumb Xhufi, "Shqiptarët dhe Anzhuinët", *Studime Historike 2* (1986).

Pëllumb Xhufi, "Shteti i Arbërit", *Shkenca dhe jeta 1* (1991).

Pëllumb Xhufi, "Skurrajt e Arbërit", *Studime Historike 2* (1991).

Pëllumb Xhufi, *Dilema e Arbërit. Studime mbi Shqipërinë mesjetare*, bot. Pegi, Tiranë 2006.

Pëllumb Xhufi, *Nga Paleologët te Muzakajt. Berati dhe Vlora në shekujt XII-XV*, bot. 55, Tiranë 2009.

Petrika Thëngjilli, *Historia e Popullit Shqiptar*, bot. ShBLU, Tiranë 2009

Shqiptarët dhe trojet e tyre, redaktorë: Selami Pulaha, Seit Mansaku, Andromaqi Gjergji, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, bot. "8 Nentori", Tirane 1982.

Skënder Anamali & Myzafer Korkuti, "Problemi ilir dhe i gjenezës së shqiptarëve në dritën e kërkimeve arkeologjike shqiptare", *Studime Historike 2* (1969).

Skënder Anamali, "Problemi i kulturës së hershme Shqiptare në dritën e zbulimeve të reja arkeologjike", *Studime Historike 2* (1967).

Spiro Shkurti, "Gjurmime në jetën ekonomike të qyteti mesjetar", *Kultura popullore 1-2* (2000).

Spiro Shkurti, "Vendbanimet fshatare dhe ekonomia bujqësore në Shqipërinë mesjetare", *Etnografia Shqiptare 17* (1997).

The Medieval Albanians, International Symposium 5, National Hellenic Research Foundation – Institute for Byzantine Research, Athens 1998.

Zamputi I, "Autonomitë e qyteteve shqiptare të prinipales së Balshajve dhe pasojat negative të pushtimit venedikas. Fundi i shek. XIV – fillimi i shek. XV", *Studime Historike 3* (1980).